

Vendim nr. 214 datë 19.10.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

| | |
|-------------------|----------|
| Holta Zaçaj, | Kryetare |
| Fiona Papajorgji, | Anëtare |
| Sonila Bejtja, | Anëtare |

në datën 19.10.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES:

KRENAR DRAZHI

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimeve nr. 10724, datë 15.12.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 362, datë 28.02.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-2898, datë 22.12.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 18, 33, 41, 42, 43, 44, 122, pika 2, 131, pika 1, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet rezulton se ndërmjet palëve ndërgjyqjese në procesin gjyqësor të kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) ka pasur një marrëdhënie huaje, ku shtetasi A.A. ka qenë në cilësinë e debitorit, ndërsa shtetasi S.Xh. në cilësinë e kreditorit. Ky i fundit ka kërkuar pranë shërbimit përbarimor privat ekzekutimin e titullit ekzekutiv, deklarata noteriale datë 28.01.2013, për të cilën është lëshuar urdhri i ekzekutimit me vendimin nr. 3117, datë 05.06.2013. Për të ekzekutuar këtë titull ekzekutiv, nga shërbimi përbarimor privat është vendosur sekuestro mbi një pasuri të paluajtshme të shtetasit A.A. Për shkak të mosgjettjes së këtij të fundit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4067, datë 09.05.2017, ka caktuar një mbrojtës për të dhe kryerja e veprimeve të mëtejshme përbarimore i është bërë mbrojtësit.

2. Më pas, shërbimi përbarimor privat ka zhvilluar ankandin për shitjen e sendit të paluajtshëm sekuestruar shtetasit A.A., dhe në përfundim ka shpallur fitues kërkuar. Me marrjen dijani të këtij fakti, shtetasi A.A. i është drejtuar rrugës gjyqësore me kërkesëpadi, me objekt kundërshtimin e veprimit përbarimor nr. 125/32 prot., datë 13.11.2017 për zhvillimin e ankandit për shitjen e sendit të paluajtshëm dhe veprimit përbarimor nr. 125/33 prot., datë 13.11.2017 për shpalljen e fituesit të ankandit. Në këtë proces gjyqësor kanë marrë pjesë në cilësinë e personave të tretë shërbimi përbarimor privat dhe shtetasi S.Xh.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1074, datë 15.12.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim shtetasi A.A., duke kërkuar ndryshimin e tij dhe pranimin e kërkesëpadisë, si dhe kundërankim shërbimi përbarimor privat, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 362, datë 28.02.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit. Ndaj këtij vendimi kanë bërë rekurs personat e tretë, shërbimi përbarimor dhe shtetasi S.Xh.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-2889, datë 09.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), si dhe revokimin e vendimit nr. 247, datë 14.05.2018 të tij, me të cilin është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës së apelit.

6. Kërkuesi në datën 28.07.2023 i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të mësipërme (*shih paragrafët 3-5 më sipër*).

7. Bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në afatin 3-mujor për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit 8577/2000, nuk llogaritet periodha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, duke argumentuar se:

8.1. *Është cenuar e drejta e pronës, si pasojë e cenimit të së drejtës së e aksesit, së drejtës së mbrojtjes efektive, së drejtës për t’u gjykuar, parimit të barazisë para ligjit dhe parimit të kontradiktoritetit, nga gjykata e shkallës së parë, pasi ajo nuk e ka thirrur kërkuesin si palë në gjykim. Edhe pse gjykimi është iniciuar nga kërkesëpadia e shtetasit A.A., me palë të paditura shtetasin S.Xh. dhe shërbimin përmbartimor, kërkuesi, si fitues i ankandit, i cili ka shlyer çmimin e sendit dhe ka fituar pronësinë mbi të, preket drejtpërdrejt nga ky gjykim. Në këtë kuptim, kërkesëpadia e marrë në shqyrtim nga gjykata e shkallës së parë ka qenë me të meta procedurale, pasi nuk është formuar saktë ndërgjyqësia, duke cenuar kështu edhe gëzimin e qetë të pronës.*

8.2. *Është cenuar e drejta e pronës në drejtim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve nga gjykata e apelit, pasi ajo duhet të vendoste prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, duke urdhëruar këtë të fundit të bënte një hetim të plotë dhe të plotësonte të metat e padisë për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë. Pas blerjes së sendit në ankand, është përfshirë edhe banka si person i tretë me të drejta mbi të, e cila gëzon të drejtën e hipotekës, për shkak të kredisë që i ka dhënë kërkuesit.*

8.3. *Është cenuar parimi i barazisë para ligjit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi në rastin konkret, për sa i takon formimit të drejtë të ndërgjyqësisë në proceset e shpalljes së pavlefshmërisë së një ankandi publik, ai kolegji ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga Kolegji Administrativ. Gjithashtu, Kolegji Civil i*

Gjykatës së Lartë ka zhvilluar një proces të parregullt ligjor, pasi respektimi i së drejtës procedurale dhe interpretimi i ligjit janë detyra të tij, të cilat nuk i ka bërë në rastin konkret.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në analizë të verifikimit të plotësimin të këtyre kriterëve, Kolegji vëren se palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuari janë shtetasit A.A. (debitori), S.Xh. (kreditori) dhe shërbimi përmbarimor privat. Ndërkohë, kërkuari nuk ka qenë palë në këtë proces gjyqësor në asnjë prej shkallëve të gjykimin dhe nuk ka pretenduar se ka kërkuar të marrë pjesë në të ose të ndërhyjë në një nga cilësitë që parashikojnë dispozitat procedurale civile.

11. Siç rezulton edhe nga aktet e sjella nga kërkuari, në zbatim të vendimeve gjyqësore objekt kërkesë, shërbimi përmbarimor privat ka nisur procedurat për kthimin e shumës së përfituar nga shtetasi S.Xh. (kreditori) nga shitja e sendit të paluajtshëm në ankand, duke vendosur edhe sekuestron konservative për pasurinë e paluajtshme të tij (shtetasit S.Xh. – kreditorit). Në këtë kuptim, edhe pse objekt ankandit ka qenë prona e kërkuarit (përfituar nëpërmjet ankandit), për të cilën ai mund të ketë interes të drejtpërdrejtë, Kolegji evidenton se ai nuk ka qenë palë në procesin e kundërshtuar dhe nuk ka provuar se nuk mjete të tjera ligjore për të kërkuar mbrojtjen e kësaj të drejte. Për rrjedhojë, në kuptim të

neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, kërkuesi nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës me këtë ankim kushtetues.

12. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.